



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština – Assembly

Legjislatura VIII

Komisioni për Buxhet, Punë dhe Transfere
Mbledhja nr.07/24
Prishtinë, më 3.4.2024, në orën 11:00
Ndërtesa e Kuvendit të Kosovës, Salla C-203

Procesverbal

Në mbledhje morën pjesë: Armend Muja, Mërgim Lushtaku, Enver Haliti, Jeta Statovci, Visar Korenica, Eman Rrahmani, Avdullah Hoti dhe Duda Balje.

Munguan: Ferat Shala dhe Pal Lekaj.

Të ftuar: Vjosa Gradinaj, kryetare, OSHP, Isa Hasani, anëtar, OSHP, Vedat Poterqoi, anëtar, OSHP, Agim Sheqiri, zv. i kryesuesit, OSHP.

Pjesëmarrës të tjerë: Driada Thaçi, zyrtare për bashkëpunim, ZKA; Ema Krasniqi, praktikante, KDI; Natyra Salihaj, gazetare, Ekonomia online; Leonita Latifi, “Political and Democracy Team”, Ambasada Britanike; Nexhmije Ahmeti, zyrtare; Arben Kabashi, monitorues, INPO; Anduena Shtavica, GP LDK; Festim Bytyçi, këshilltar, GP AAK; Munib Durguti, asistent, Kuvend; Sami Gashi, GP LVV, Egzona Tërdevci, GP LVV, Elsa Krasniqi, GP LVV.

Stafi mbështetës i Komisionit: Sabrije Saliuki- Iseini, Luljetë Krasniqi.

Mbledhjen e kryesoi Armend Muja, kryetar i Komisionit.

Rendi i ditës:

- 1. Miratimi i rendit të ditës;**
- 2. Miratimi i procesverbaleve nga mbledhjet e mbajtura më datë 23.2.2024 dhe 6.3.2024;**
- 3. Shqyrtimi i raportit me rekomandime i Komisionit FunkSIONAL për Administratë Publike, Pushtet Lokal, Media dhe Zhvillim Rajonal, për Projektligjin nr. 08/L-262 për**

ndryshimin dhe plotësimi e ligjeve që përmbajnë procedura të veçanta administrative dhe harmonizimin e tyre me Ligjin nr.05/L-031 për procedurën e përgjithshme administrative, faza e dytë;

- 4. Shqyrtimi i raportit vjetor financiar i Zyrës Kombëtare të Auditimit për vitin 2022 dhe 2023;**
- 5. Shqyrtimi i raportit vjetor të punës së Organit Shqyrtues të Prokurimit për vitin 2023;**
- 6. Të ndryshme.**

1.Miratimi i rendit të ditës

Kryetari: Propozoj plotësimin e rendit të ditës dhe vendosjen si pikë të pestë të raportit plotësues për Projekt-Kodin Doganor dhe të Akcizave, pra na duhet ta bëjmë një ndryshim te hyrja në fuqi e ligjit. Po ashtu, nga ZKA kanë informuar se auditorja, znj.Vlora Spanca, është në udhëtim jashtë vendit dhe nuk mund të jetë sot në raportim në Komision, andaj kjo pikë e rendit të ditës, shtyhet për mbledhjen e radhës.

Pasi hodhi në votim, kryetari konstatoi se me shumicë votash, miratohet rendi i ditës, me ndryshime.

2.Miratimi i procesverbaleve nga mbledhjet e mbajtura më datë 23.2.2024 dhe 6.3.2024

Kryetari konstatoi se me shumicë votash, miratohen procesverbalet nga mbledhjet e mbajtura më datë 23.2.2024 dhe 6.3.2024.

3.Shqyrtimi i raportit me rekomandime i Komisionit Funkcional për Administratë Publike, Pushtet Lokal, Media dhe Zhvillim Rajonal, për Projektligjin nr. 08/L-262 për ndryshimin dhe plotësimi e ligjeve që përmbajnë procedura të veçanta administrative dhe harmonizimin e tyre me Ligjin nr.05/L-031 për procedurën e përgjithshme administrative, faza e dytë

Kryetari: Projektligjin nr. 08/L-262 për ndryshimin dhe plotësimin e ligjeve që përmbajnë procedura të veçanta administrative dhe harmonizimin e tyre me Ligjin nr.05/L-031 për procedurën e përgjithshme administrative, faza e dytë, është shqyrtuar nga Komisioni Funkcional Administratë Publike, Pushtet Lokal, Media dhe Zhvillim Rajonal, i cili komision ka dërguar raportin me amendament.

Komisioni për Buxhet, Punë dhe Transfere, në cilësinë e komisionit të përhershëm, deklarohet për koston shtesë të projektligjit dhe amendamenteve dhe raportin me rekomandime e procedon te Komisioni funksional.

Departamenti i Buxhetit në Ministrinë e Financave, vlerëson se Projektligjin nr. 08/L-262 për ndryshimin dhe plotësimin e ligjeve që përmbajnë procedura të veçanta administrative dhe harmonizimin e tyre me Ligjin nr.05/L-031 për procedurën e përgjithshme administrative, faza e dytë, nuk do të ketë kosto shtesë buxhetore mbi planifikimet buxhetore të parapara me ligjin mbi ndarjet buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitit 2024.

Kryetari konstatoi se Komisioni, me shumicë votash, nxori këtë:

R e k o m a n d i m

1. Projektligjin nr. 08/L-262 për ndryshimin dhe plotësimi e ligjeve që përmbajnë procedura të veçanta administrative dhe harmonizimin e tyre me Ligjin nr.05/L-031 për procedurën e përgjithshme administrative, faza e dytë, nuk përmban kosto shtese buxhetore;
2. Amendamenti i propozuar nga Komisioni për Administratë Publike, Pushtet Lokal, Media

dhe Zhvillim Rajonal, për Projektligjin nr. 08/L-262 për ndryshimin dhe plotësimin e ligjeve që përmbajnë procedura të veçanta administrative dhe harmonizimin e tyre me Ligjin nr.05/L-031 për procedurën e përgjithshme administrative, faza e dytë, nuk përmban kosto shtesë buxhetore.

4. Raport plotësues për Projekt-Kodin Doganor dhe të Akcizave

Kryetari: Komisioni për Buxhet, Punë dhe Transfere, në pajtim me nenin 76 të Rregullores së Kuvendit, në mbledhjen e mbajtur më 3 prill 2024, shqyrtoi raportin me amendamente, të datës 14.12.2023, për Projekt Kodin Doganor dhe Akcizave nr.08/L-247, dhe vendosi që Kuvendit t’ia paraqesë këtë:

Raport plotësues

1. Tërhiqet raporti plotësues, nr. 08/5127/L-247, datë 8 mars 2024.

2. I propozohen Kuvendit për miratim amendamentet si në vijim:

Amendamenti 1

Neni 124, i projektkodit, paragrafi 4 - referenca “në nënparagrafin 3.3 të këtij neni” zëvendësohet me referencën “në nënparagrafin 2.3 të këtij neni”.

Amendamenti 2

Neni 268, paragrafi 3, ndryshohet si në vijim:

3. “Drejtori i Përgjithshëm ka mandat katër (4) vjeçar, me mundësi të riemërimit edhe për një mandat me vendim të Kryeministrit, me propozim të ministrit përkatës të Financave, pa zhvilluar procedurat e rekrutimit të parapara në paragrafin 1 të këtij neni”.

Amendamenti 3

Neni 269, paragrafi 2, ndryshohet si në vijim:

2. “Drejtori i Përgjithshëm shkarkohet nga detyra me vendim të Kryeministrit, para përfundimit të mandatit, pas propozimit të ministrit përkatës të Financave, edhe për së paku njëherë nga arsyet e mëposhtme:”

Nën paragrafët vazhdojnë si në projektligj.

Amendamenti 4

Neni 269, paragrafi 3, ndryshohet me tekstin si në vijim:

3. “Në rastet e shkarkimit, dorëheqjes ose pezullimit të drejtorit të Përgjithshëm, me propozim të ministrit përkatës për Financa, Kryeministri emëron ushtrues detyre, njërin nga vartësit e drejtorit të Përgjithshëm, sipas gradës më të lartë hierarkike për një periudhë jo më të gjatë se gjashtë (6) muaj”.

Amendamenti 5

Neni 331, paragrafi 6, referenca “sipas nënparagrafëve 1.1, 1.2, 1.3, 1.4 dhe 1.5 të këtij neni” zëvendësohet me referencën “sipas nënparagrafëve 1.1, 1.2, 1.3, 1.4 të këtij neni”.

Amendamenti 6

Neni 481, paragrafi 2, ndryshohet si në vijim:

2. “Importimin dhe blerjet, përfshirë eksportin e produkteve relevante, materialeve, makinerisë, veglave dhe bagëtisë që ndërlidhen me aktivitetet sipas paragrafit 1 të këtij neni.

Amendamenti 7

Neni 487, ndryshohet si në vijim:

**Neni 487
Hyrja në fuqi**

Ky Kod hyn në fuqi pesëmbëdhjetë (15) ditë pas publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Kryetari konstatoi që me shumicë votash, Komisioni e miratoi raportin plotësues, me amendamentet e propozuara.

5. Shqyrtimi i raportit vjetor të punës së Organit Shqyrtues të Prokurimit për vitin 2023

Kryetari: Në bazë të nenit 98, paragrafi 3 i Rregullores së Kuvendit, Komisioni përgjegjës-raportues shqyrton raportin vjetor të Organit Shqyrtues të prokurimit Publik. Në bazë të nenit 120 dhe 121 të Ligjit nr. 04/L-042 për prokurim të Republikës së Kosovës, Organi Shqyrtues i Prokurimit është i obliguar që për çdo vit kalendarik t’i sigurojë Kuvendit të Kosovës, një raport vjetor që analizon llojet e procedurave dhe objekteve të aktivitetit përkatës të prokurimit publik.

Komisioni për Buxhet, Punë dhe Transfere, në cilësinë e Komisionit funksional, e shqyrton raportin e OSHP-së.

Komisioni për Buxhet, Punë dhe Transfere, në cilësinë e Komisionit funksional, sot vetëm do të diskutojë lidhur me raportin për vitin 2023, ndërsa rekomandimin do ta nxjerrë pasi që të raporti i OSHP-së, për vitin 2023, të jetë shqyrtuar nga Komisioni për Mbikëqyrjen e Financave Publike, ashtu siç parashihet me rregullore.

Lidhur me këtë pikë, kemi ftuar kryetaren e Organit Shqyrtues të Prokurimit, znj. Vjosa Gradinaj, nga e cila kërkojmë që të prezantojë dhe të arsyetojë raportin financiar të OSHP-së, për vitin 2023.

Vjosa Gradinaj: Në këtë rast, duke iu referuar pozitës sime, si kryesuese e këtij bordi dhe autorizimeve të parapara me nenin 102 të Ligjit për prokurimin publik të Republikës së Kosovës, më lejoni t'ju vë në dijeni se të gjithë anëtarët e bordit, në përbërjen aktuale të tij, por jo në përbërje konkrete, janë të pranishëm sot që të prezantojmë raportin. Ky bord është i vetëdijshëm për besimin e dhënë nga ky Parlament, prandaj është duke përpjekur me përkushtim dhe me mund, përtej orarit të rregullt, t'i zbatojë detyrat e tij, por jo vetëm në këtë. Në këtë kontekst, ju lutem, më lejoni që shkurtimisht t'ju informojë edhe sesi po vijon. Bordi aktual ka marrë pjesë në disa konferenca, dhe siç e dini, ju është edhe anëtar i rrjeteve të Evropës Juglindore, të OSHP-ve, të rrjeteve të Evropës Juglindore. I kemi shkëmbyer të gjitha praktikat tona më të mira dhe kemi marrë praktikat më të mira nga vendet më të avancuara të Evropës, siç janë: Turqia, Sllovenia, Kroacia e të tjera. Sa i përket Administratës së OSHP-së, më lejoni t'ju njoftoj që OSHP ka trashëguar një administratë jo të kompletuar, me vetëm 21 punëtorë nga 30 sa ishin të lejuar. Aktualisht, jemi në fazën e rekrutimit edhe për stafin tjetër të mbetur dhe vetëm sot kemi pranuar 3 dorëheqje nga pozitat kyçe. Unë mendoj që po ndikon edhe puna shpesh, që po ngarkohen punëtorët e OSHP-së, përveç detyrave të përditshme që i kanë në kontratat e punës. Po ashtu, ky bord, në vitin 2023 ka lëshuar për herë të parë mekanizmin për plasimin e lëndëve në mënyrë elektronike, që do të thotë se tani të gjitha lëndët pranohen vetëm në mënyrë elektronike, përzgjedhja bëhet vetëm në mënyrë elektronike. Sa i përket vitit 2023, OSHP ka pranuar gjithsej 1071 lëndë. Aktualisht, OSHP nuk ka fare IT për menaxhimin e sistemit, domethënë punën e IT-së janë duke e kryer zyrtarë tjetër, çfarë për neve rezulton në ngecje të vazhdueshme. Në total vitin 2023, kemi pasur 256,170 euro për paga dhe 135.000 euro për mallra dhe shërbime. Kemi arritur të shpenzojmë 149.000 euro për mallra dhe shërbime dhe 222, 073 euro për paga dhe mëditje.

Isa Hasani: Është shqetësuese lëvizja e stafit profesional, lëvizin ekspertët shqyrtues dhe zyrtarët ligjorë. Po mendojmë të bëjmë një kërkesë për t'i shikuar mundësitë, që t'iu jepet një lloj shtese këtij stafi mbi bazën ligjore. Ekspertët e mirë nuk vijnë me koeficient 5.70.

Avdullah Hoti: Mendoj që është shumë shqetësuese kjo lëvizja e stafit, tash besoj se jeni duke i parë efektet e Ligjit për paga, i cili nuk ka pasur asnjë analizë. Ju i keni staf 21, prej tyre 13 janë ndërruar. Cila është arsyeja kryesore?

Agim Sheqiri: Arsyeja numër 1 është koeficienti i ulët. Ata marrin krahasime me Agjencinë e Parandalimit të Konfliktit të Interesit, të cilët janë trajtuar ndryshe.

Avdullah Hoti: A mund të konstatojmë që vonesat janë për shkak të mungesës së stafit?

Agim Sheqiri: Po, është edhe për shkak të stafit.

Avdullah Hoti: Në pamundësi të shqyrtimit të lëndëve në kohë, shkelet e drejta themelore e bizneseve. Kush i paguan gjambat e shqiptuara?

Agim Sheqiri: Institucioni i paguan. Më herët ka qenë edhe zyrtari përgjegjës i prokurimit, tash është autoriteti kontraktues.

Avdullah Hoti: Tash jeni 3 anëtarë, ligji e parasheh se kur duhet të jenë 5 anëtarë në disa lëndë.

Vedat Poterqoi: Nuk parashihet me ligj, vetëm parashihet që panelet shqyrtuese, duhet të kenë 1, 3 ose 5 anëtarë.

Vjosa Gradinaj: Bordi asnjëherë nuk ka funksionuar me 5 anëtarë, të gjendur në një situatë të tillë dhe me qëllim të rritjes së efikasitetit, e kemi konsideruar të arsyeshme që lëndët në vlerë deri 300 mijë euro, të trajtohen nga 1 anëtar. Ne merremi me procedurat dhe jo me vlerat. Kroacia p.sh. i trajton të gjitha lëndët me nga 3 anëtarë.

Avdullah Hoti: Në faqe 37, shuma e konfiskuar e tarifave është 400 mijë euro, në krahasim me 54 mijë euro. Sa ka qenë në vitin 2020, pse ka ndodhur kjo?

Vjosa Gradinaj: Nuk i kemi prekur tarifat.

Agim Sheqiri: Zakonisht, konfiskohen ato ankesa që nuk kanë bazë ligjore. Paneli paraprak, pavarësisht a është pranuar apo anuluar, nuk ka bërë konfiskim. Një palë nëse bën ankesë dhe po ta prolongojë aktivitetin e prokurimit, është e drejtë t'i konfiskohet depozita.

Kryetari: Pyetja është valide, do t'ua bëj edhe me shkrim, është e vërtetë që është rritur numri i ankesave, por jo aq shumë.

Eman Rrahmani: Duhet të ketë krahasime me vitet paraprake. Është shqetësues numri i ulët i punëtorëve. OSHP është e pamundur të trajtohet gjithë ai numër i ankesave. Edhe kur kanë bërë kërkesë për staf shtesë, është refuzuar me arsyetimin se do të ketë ndryshim të Ligjit të prokurimit. Është e pamundur që 1 zyrtar të trajtojë 3-4 ankesa në ditë. Sa i përket numrit të paneleve, në rregulloren e re, a parashihet e njëjta?

Vjosa Gradinaj: Nuk e dimë ende, sepse nuk e dimë a do të kompletohet bordi.

Avdullah Hoti: Po vendosni drejtësi kontekstuale.

Vjosa Gradinaj: Gjykatat e vlerësojnë punën tonë. Për vitin 2023, kemi pranuar vetëm 25 padi kundrejt vendimeve tona.

Eman Rrahmani: Te kontratat, ku është 1 anëtar, kush është pjesë tjetër gjatë shqyrtimit?

Vjosa Gradinaj: Zyrtari ligjor.

Eman Rrahmani: Marrë parasysh mesataren e trajtimit të ankesave, i bie që çdo ditë pune e keni marrë një vendim.

Vjosa Gradinaj: Po.

Eman Rrahmani: Sa kohë u duhet ta trajtoni një lëndë në mënyrë profesionale? Unë nuk besoj në këto vendime shkaku i kohës së trajtimit, kufizimit të stafit. Te rregullorja po më intereson a ka qenë e specifikuar kur duhet me qenë paneli shqyrtues me 5, kur me 3 anëtarë?

Visar Korenica: Në raportin që keni sjellë për seancat gjyqësore, ku keni marrë pjesë, a ka ndonjë përfundim?

Vjosa Gradinaj: Po, i kemi, por zakonisht operatorët i kontestojnë vendimet edhe në shkallë të tjera.

Visar Korenica: Ju angazhoni edhe ekspertë të jashtëm, a i vlerësoni ju raportet që i sjellin këta ekspertë apo i miratoni?

Isa Hasani: 80 % të rasteve ne i miratojmë.

Eman Rrahmani: Çfarë përgjegjësie marrin ata nëse nuk është ekspertiza e drejtë?

Isa Hasani: Ndiqen penalisht në bazë të ligjit.

Visar Korenica: Duhet pasur parasysh se janë edhe 69 ekspertë të tjerë që marrin pjesë, ju nuk po i përmendni hiq.

Eman Rrahmani: Prej këtyre 69 ekspertëve, për sa lëndë kanë dhënë mendime, sa raporte i kanë hartuar?

Kryetari: Në sa raste jeni bazuar në ekspertizën e tyre dhe në sa jo? Na dërgoni me shkrim.

Visar Korenica: Dallimi në konfiskim të depozitave ndërmjet vitit 2020 dh 2023, është shumë i madh. Buxhetit i është bërë dëm, duhet të mbajë përgjegjësi dikush për mosveprim.

Mërgim Lushtaku: 307 ankesa brenda afatit janë shqyrtuar për 3 muaj, po më duket numër i madh. A i keni bërë që të dilni statistikisht më mirë, a kanë qenë të kategorisë individuale?

Vjosa Gradinaj: INPO i ka marrë vetëm vendimet ku japim gjykime meritore.

Mërgim Lushtaku: A është publikuar ndryshimi në rregullore, sepse ka pasur kritika?

Vjosa Gradinaj: Po, na ka ikur si procedurë.

Kryetari: A ka pasur deputetë, zyrtarë qeveritarë që ju ka kushtëzuar për të marrë ndonjë vendim?

Vjosa Gradinaj: Kjo është shprehimisht e ndaluar. Asnjë deputet, as nga opozita e as nga pozita, nuk ka ardhur gjatë këtij mandati.

Kryetari: Tarifat e konfiskuara, në krahasim me ankesat, në vitin 2023 ka pasur më pak ankesa, por janë konfiskuar më shumë sesa në vitin 2020, do t'iu dërgohet me shkrim pyetja për sqarime. Çështja e ankesave për staf, ju në raport po thoni që buxheti për pozita nuk ka arritur të shpenzohet. Edhe në vitin 2020 shënimi ka qenë i njëjtë. Pra, që 3 vjet është problem i njëjtë dhe vazhdimisht vini me të njëjtën ankesë. Pse e keni këtë justifikim vazhdimisht? Ju i keni pozitat e lejuara që nuk po i plotësoni. A bën një shpjegim?

Agim Sheqiri: Ne thamë që 13 punëtorë kanë lëvizur, të cilët është dashur të zëvendësohen. Është çështja e koeficientit.

Kryetari: Pra, nuk është çështja e moslejimit të pozitave, por te koeficienti.

Agim Sheqiri: Dorëheqjet që i kemi marrë, kanë dhënë arsyetimin e pagës së ulët, si shkak për largimin.

Kryetari: I keni 35 pozita të lejuara dhe tash i keni vetëm 19 veta staf. Në faqe 9 të aneksit, shërbimi për ekspertë, ju thoni se janë shpenzuar 68 mijë euro, që është dukshëm më e lartë se shumica e shpenzuar sesa vitet paraprake. Numrin e kontratave me shërbime të veçanta e keni pasur po ashtu rekord. Por, performanca nuk po përmirësohet. A ka ndonjë kufizim nga ndonjë institucion për numrin e ekspertëve?

Vjosa Gradinaj: Jo.

Kryetari: Në bazë të nenit 99 të Ligjit për prokurim publik, për paraqitje të rreme të të dhënave, skualifikohet autoriteti kontraktues. Mua më ka ardhur një ankesë nga Spitali i Gjakovës për operatorin “Pharma Leader” dhe nga Ministria e Mbrojtjes për operatorin “Beni Dona”.

Vjosa Gradinaj: Jemi në shqyrtim.

Kryetari: Sa kohë ju duhet juve?

Vjosa Gradinaj: Varësisht nga kompleksiteti i lëndës.

Kryetari: Ndërkohë që këto po shqyrtohen, operatorët ekonomikë po tenderohen. Po më intereson, kur janë marrë kërkesat, sa janë futur në listë të zezë, kur është marrë vendimi? Na i dërgoni me shkrim. Jemi në një debat për kontratat e negociuara. Një tender me Microsoft në vlerë 15 milionë euro, ju e keni trajtuar këtë. Ju keni thënë se autoriteti kontraktues ka vepruar në harmoni me ligjin.

Vjosa Gradinaj: Po, është vendim i OSHP-së.

7. Të ndryshme

Nuk pati ndonjë çështje për diskutim.

Mbledhja përfundoi në orën 13:45.

E përgatiti: Stafi mbështetës i Komisionit.

Armend Muja,

Kryetar i Komisionit